



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 918 Prot.

Tiranë, më 24.06 2019

VENDIM Nr. 162, datë 25.06.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Shushicë" Qarku Vlorë*-subjekti "Shushica Hydropower" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Investitori të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji, i cili të kryejë pastrimin dhe dokumentimin e rrënojave të fshatit mesjetar (Ledhet) pranë fshatit Brataj dhe rrënojave të kishës dhe manastirit të Shën Gjergjit.
2. Të shikohet mundësia e devijimit të gjurmës së projektit te zona e varrezave antike të Lepenicës, duke u spostuar drejt lindjes, pranë fundit të kodrave. Për zonën e varrezave antike e Lepenicës, të paraqitet nga subjekti i licencuar në arkeologji një koncept sondazhesh.
3. Në hartën me gjurmën e re të projektit të hidhen rrugët e aksesit, venddepozitimet e dherave, të cilat do të dalin nga gërmimet e zbatimit të projektit, si dhe sitet e tjera të identifikuara më parë në këtë zonë:
 - Siti i periudhës së Antikitetit të Vonë në fshatin Gjorm (Trakti nr.3, sipas raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor);
 - Siti i periudhës prehistorike (Bronz i Vonë) në fshatin Brataj (Trakti nr.2, sipas raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor);
 - Siti i periudhës Helenistike dhe Antikitetit të Vonë "Guri i Kishës", në fshatin Brataj (Trakti nr.2, sipas raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor)
 - Siti i periudhës Helenistike "Moçalet", në fshatin Brataj;
 - Siti i periudhës prehistorike pranë përroit të Sklapit, në hapësirën midis fshatit Mavrovë dhe Drashovicë (Trakti nr.2, sipas raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor);
 - Siti arkeologjik i periudhës Prehistorike, Helenistike, Antikitetit të Vonë dhe Otomane, pranë fshatit Mazhar dhe Gumenicë lagjja e poshtme e tij (Trakti nr.12, sipas raportit të Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor),

duke sqaruar impaktin e projektit në lidhje me to.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

